



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 14, datë 15.02.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 110, DATË 28.07.2011 “PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË PROVIJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 10, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, si më poshtë:
 - I. Neni 4, pika 1, ndryshon si vijon:
 - “1. Provigjoni teknik i primit të pafituar, përcaktohet si më poshtë:
 - a. Shoqëria e sigurimit llogarit primin e rrezikut për produktin e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe e dërgon atë në Autoritet brenda datës 10 mars të çdo viti;
 - b. Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shkronjës “a”, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu dhe e publikon atë brenda datës 31 mars;
 - c. Shoqëria e sigurimit llogarit nivelin e provigjoneve teknike të primit të pafituar të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke u kujdesur që njëherazi:

- i. Provigjionet teknike të llogariten për çdo policë sigurimi;
- ii. Vlera e provigjioneve teknike të jetë të paktën sa vlera më e lartë midis primit të rrezikut të llogaritur nga vetë shoqëria e sigurimit sipas shkronjës “a” dhe primit të rrezikut në nivel tregu të llogaritur nga Autoriteti sipas shkronjës “b”.”

II. Neni 10, pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Shoqëria publikon primet e rrezikut si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara në faqe gjatë gjithë periudhës së zbatimit.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI